

URDHËR
Nr. 1, datë 16.10.2017

PËR DELEGIMIN E PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës, të neneve 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 7, pika 1, dhe 121 të Rregullores së Kuvendit,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit në lidhje me proceset gjyqësore dhe Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Kuvendit të Shqipërisë, në proceset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

3. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Kuvendit të Shqipërisë, në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

4. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

5. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor /gjykim në Gjykatën Kushtetuese bëhet nga autoriteti i përcaktuar në pikën 1 dhe në pamundësi të tij, rast pas rasti nga personat e përcaktuar me autorizim të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

6. Autoriteti i përcaktuar në pikën 1/personi që do të përfaqësojë Kuvendin, autorizohet për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin /rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile/gjykimit në Gjykatën Kushtetuese.

7. Përfaqësimi ligjor i Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore/Gjykatën Kushtetuese, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në të gjitha nivelet përkatëse të gjykimit.

8. Urdhri nr. 74, datë 28.10.2016, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”, shfuqizohet.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
K U V E N D I
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. ____ prot. (vendndodhja), më ____ . ____ .2017

LIDHJA 1

AUTORIZIM
PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN ADMINISTRATIVE/CIVILE ME PALË:

Paditës/Kërkues:
E paditur/Subjekt i interesuar:
Objekti:

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të urdhrit të Kryetarit të Kuvendit nr. 1, datë 16.10.2017, “Për delegimin dhe rregullat e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”,

VENDOSA:

Autorizimin e z./znj., me detyrë, për të përfaqësuar Kuvendin e Shqipërisë në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile/gjykimin në Gjykatën Kushtetuese me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në (gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjes përkatëse)/ Gjykatën Kushtetuese.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM